



REPUBLIKA E SHQIPËRISË GJYKATAKUSHTETUESE

STATISTIKA MBI VEPRIMTARINË E GJYKATËS KUSHTETUESE PËR 6 MUJORIN E PARË TË VITIT 2020

Aktualisht, numri total i kërkesave që presin të shqyrtohen nga kjo Gjykatë është gjithsej 68, nga të cilat:

- ◆ 23 kërkesa kanë kaluar për shqyrtim në seancë plenare;¹
- ◆ 22 kërkesa kanë kaluar për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.²
- ◆ 23 kërkesa janë në fazën e shqyrtimit paraprak nga Kolegjet e Gjykatës Kushtetuese;

Për 6 mujorin e parë të vitit 2020 janë regjistruar gjithsej 50 kërkesa:

- ◆ 1 kërkesë ka kaluar për shqyrtim në seancë plenare;
- ◆ 2 kërkesa kanë kaluar për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve;
- ◆ 23 kërkesa është marrë vendim moskalimi;
- ◆ 24 kërkesa janë në fazën e shqyrtimit paraprak nga Kolegjet e Gjykatës Kushtetuese;

KËRKESAT DREJTUAR GJYKATËS KUSHTETUESE GJATË 6 MUJORIT TË PARË

¹ Shqyrtimi në seancë plenare i këtyre kërkesave do të bëhet në momentin që Gjykata Kushtetuese do të ketë kuorumin e nevojshëm për shqyrtimin e tyre në seancë, sipas parashikimeve të nenit 32, pika 1 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

²Shqyrtimi paraprak i këtyre kërkesave nga Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese do të bëhet në momentin që Gjykata Kushtetuese do të ketë numrin e nevojshëm të gjyqtarëve për shqyrtimin e këtyre kërkesave, sipas parashikimeve të nenit 31/a, pika 1 të ligjit lartpërmendur.

PËR VITIN 2020
(sipas nenit 27 të ligjit nr.8577/2000, të ndryshuar)

Në 6 mujorin e parë të vitit 2020 , në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë janë paraqitur dhe regjistruar në total **50 kërkesa**, nga të cilat:


- **13** kërkesa janë paraqitur nga subjekte për ***proces të parregullt (kundërshtim vendimeve të gjykatave të zakonshme)***;
- **14** kërkesa janë paraqitur për ***konstatim të cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor***;
- **9** kërkesa janë paraqitur për papajtueshmëri të ***ligjeve (apo dispozitave të veçanta të tyre)*** me Kushtetutën;
- **1** kërkesë është paraqitur për ***Vendime të Këshillit të Ministrave***;
- **3** kërkesë është paraqitur për kundërshtim ***Vendimi të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë***;
- **8** kërkesa janë paraqitur për kundërshtim/ rishikim të Vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.
- **2** Kërkesa janë për kundërshtim të vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor





Sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese (sipas nenit 134 të Kushtetutës), gjatë 6 mujorit të parë për vitin 2020 janë paraqitur:

- 1 kërkesë nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë;
- 5 kërkesa në rrugë incidentale;
- 1 kërkesë nga Partitë Politike;
- 43 kërkesa nga individët;



VENDIMET E DHËNA NGA GJYKATA KUSHTETUESE GJATË 6 MUJORIT TË PARË TË VITIT 2020

Referuar vendimeve të dhëna nga Gjykata Kushtetuese gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2020, Kolegjet e kësaj Gjykate janë shprehur me vendim për **72 kërkesa** (vendime për moskalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë plenare), bazuar në nenin 31/a, pika 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr.8577/2000). Nga këto, sipas rasteve të parashikuara në nenin 31/1/2,

- për **8 kërkesa** që janë paraqitur nga gjyqtari/gjykata e zakonshme, Kolegji, pasi ka

verifikuar plotësimin e kriterëve ligjore për vënien në lëvizje të kontrollit kushtetues incidental, ka vendosur “Moskalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë plenare”, bazuar në nenin 145/2 të Kushtetutës dhe nenit 68 i ligjit nr.8577/2000.

- për **4 kërkesa** Kolegji ka vendosur “Moskalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë plenare”, bazuar në nenin 31/a, pika 2, shkronja “a” të ligjit nr.8577/2000 sipas të cilës, kërkimet e paraqitura nuk hyjnë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese;
- për **1 kërkesë** Kolegji ka vendosur “Moskalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë plenare”, bazuar në nenin 31/a, pika 2, shkronja “b” të ligjit nr.8577/2000, kur kërkesa nuk është paraqitur nga subjekti që legjitimohet;
- për **20 kërkesa** Kolegji ka vendosur “Moskalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë plenare”, bazuar në nenin 31/a, pika 2, shkronja “ç” të ligjit nr.8577/2000, sipas të cilës, kur vërtetohet se kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor;
- për **10 kërkesa** Kolegji ka vendosur “Moskalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë plenare”, bazuar në nenin 31/a, pika 2, shkronja “d” të ligjit nr.8577/2000, sipas të cilit, kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive para se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, ose legjislacioni në fuqi parashikon mjete efektive në dispozicion;
- për **3 kërkesa** Kolegji ka vendosur “Moskalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë plenare”, bazuar në nenin 31/a, pika 2, shkronja “dh” të ligjit nr.8577/2000, sipas të cilit, kërkimet e paraqitura në kërkesë janë objekt i një vendimi të mëparshëm të Gjykatës Kushtetuese, ose rivendosja në vend e së drejtës së shkelur nuk është e mundur;
- për **8 kërkesa** Kolegji ka vendosur “Moskalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë plenare”, bazuar në nenin 31/a, pika 2, shkronja “e” të ligjit nr.8577/2000, sipas të cilit, kërkesa është haptazi e pabazuar;
- për **2 kërkesa** Kolegji ka vendosur “Moskalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë plenare”, bazuar në nenin 31/a, pika 2, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr.8577/2000, sipas të cilave kërkimet e paraqitura nuk hyjnë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese; si dhe kur kërkesa nuk është paraqitur nga subjekti që legjitimohet;
- për **4 kërkesë** Kolegji ka vendosur “Moskalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë plenare”, bazuar në nenin 31/a, pika 2, shkronjat “a” dhe “ç” të ligjit nr.8577/2000, sipas të cilave kërkimet e paraqitura nuk hyjnë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese; si dhe kur vërtetohet se kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor;
- për **2 kërkesë** Kolegji ka vendosur “Moskalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë

plenare”, bazuar në nenin 31/a, pika 2, shkronjat “a”, dhe “e” të ligjit nr.8577/2000, sipas të cilave kërkimet e paraqitura nuk hyjnë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese; si dhe kur kërkesa është haptazi e pabazuar;

- për **1 kërkesë** Kolegji ka vendosur “Moskalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë plenare”, bazuar në nenin 31/a, pika 2, shkronjat “a” , “d” dhe “e” të ligjit nr.8577/2000, sipas të cilave kërkimet e paraqitura nuk hyjnë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese; kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive para se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, ose legjislacioni në fuqi parashikon mjete efektive në dispozicion; si dhe kur kërkesa është haptazi e pabazuar;


- për **1 kërkesë** Kolegji ka vendosur “Moskalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë plenare”, bazuar në nenin 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e” të ligjit nr.8577/2000, sipas të cilave kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive para se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, ose legjislacioni në fuqi parashikon mjete efektive në dispozicion; si dhe kur kërkesa është haptazi e pabazuar;

- për **4 kërkesë** Kolegji ka vendosur “Moskalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë plenare”, bazuar në nenin 31/a, pika 2, shkronjat “ç” dhe “d” të ligjit nr.8577/2000, **kur vërtetohet se kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor**; si dhe kur kërkesa është haptazi e pabazuar;

- për **2 kërkesa** Kolegji ka vendosur “Moskalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë plenare”, bazuar në nenin 31/a, pika 2, shkronjat “ç”, “d” dhe “e” të ligjit nr.8577/2000, sipas të cilave vërtetohet se kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor; kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive para se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, ose legjislacioni në fuqi parashikon mjete efektive në dispozicion; si dhe kërkesa është haptazi e pabazuar;

- për **2 kërkesa** Kolegji ka vendosur “Kthimin e kërkesës për plotësim”, bazuar në nenin 31 pika 2 të ligjit nr.8577/2000.

VENDIMET E DHËNA NGA GJK Janar - Qershor 2020



Nga totali i vendimeve të dhëna gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2020 (72 vendime);

- 22 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura në vitin 2018;
- 27 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura në vitin 2019;
- 23 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura në vitin 2020;

Përgatiti:
Drejtoria Gjyqësore dhe e Dokumentacionit